



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

692/20
20.10.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

DATË/A:	20 TETOR 2020
REFERENCË:	692/20
PËR/ZA/TO:	AK- "KK Prishtinë"
NGA/OD/FROM:	Blerim Dina - Kryetar i OSHP-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM

Operatori ekonomik "Integral SHPK&Milenium Konstruktion SHPK"- Prishtinë, si palë e pakënaqur me datën: 21.09.2020, kanë parashtruar në OSHP ankesën me numër 692/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë" me nr të prokurimit 616-19-1015-5-1-1, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 1, 6, 7, 59, 60, 64, 69, dhe 72 të LPP-së.
- Vendimi i OSHP-së Nr.317/20 i dt.10.07.2020

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 30 Shtator 2020 kanë autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit me datën 12.10.2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues të aprovet, dhe se vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet, lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti kontraktues- "KK Prishtinë" me datën 12 Tetor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertës shqyrtuese të prokurimit dhe të njëjtit me datën 19 Tetor 2020 përmes parashtrësës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se PAJTOHEN me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues **“Integral SHPK & Milenium Konstruktion SHPK” - Prishtinë** me datën 12 Tetor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertese shqyrtuese dhe të njëjtit me datën 13 Tetor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues - **“KK Prishtinë”** për aktivitetin e prokurimit **“Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë”** me nr të prokurimit **616-19-1015-5-1-1** dhe njëkohësisht kanë konstatuar se e OE ankues te **të aprovohet, dhe se vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet, lënda të kthehet në Rivlerësim**, konform mendimit të dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik **“Integral SHPK & Milenium Konstruktion SHPK” - Prishtinë** konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.